



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 11 të Ligjit nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor, nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, neneve 14 dhe 15 parag. 2.4 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2019 – 2023 në Komunën e Podujevës, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-948/03-0072034/17 dt.19.09.2017 për fillimin e hartimit të Hartës Zonale, si dhe aktit të vlerësimit të përputhshmërisë me nr.prot.SP-02/7116-2/19 të datës 17.01.2020 të MMPH, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2020, mori,

VENDIM PËR VËNIEN NË SHQYRTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në shqyrtim publik

- **Projekt Harta Zonale e Komunës së Podujevës 2020 - 2028, në Komunën e Podujevës.**

Neni 2

Shqyrtimi publik sipas nenit 1, zgjat 30 ditë përkatësisht prej **04 shkurt 2020 deri më 04 mars 2020**. Debati publik me qytetarë dhe profesionist të kësaj fushe mbahet më **21 shkurt 2020** duke filluar nga **ora 13:15, në ish sallën e mbledhjeve të Kuvendit në objektin e vjetër të Komunës**.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së shqyrtimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e re e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat; nazmi.elezi@rks-gov.net dhe bujar.gimolli@rks-gov.net, të cilat pastaj përçjellën në Drejtorinë përkatëse, brenda periudhës së shqyrtimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> **(rubrika; aktet për diskutim publik)**

Neni 5

Shqyrtimi publik zbatohet nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Ekipi komunal për ofrimin e ndihmës profesionale për hartimin e Hartë Zonale të Komunës së Podujevës në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, që përkujdesen për përgatitjen e raportit nga diskutimi / debati publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-350/05-0007438/20
Podujevë, 31 janar 2020



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi